VENDIM
Nr.369, datë 14.6.2006

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për përcaktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e degëve të tatimeve, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1), Diplomë e shkollës së lartë, e lidhjeve nr.1 e nr.2, të jetë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2), e lidhjeve nr.1 e nr. 2, të jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

5. Shtesa për kualifikim (kolona 3), e lidhjeve nr.1 e nr.2, është 0.

6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4, të lidhjeve nr.1 e nr.2.

7. Vendimi nr.437, datë 3.9.1993 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të tatime dhe të doganave", i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave dhe nga fondi limit i planifikuar për shpërblimet në sistemin tatimor.

9. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

		PAGA INDIVIDUALE			PAGA MUJORE		
	POZICIONI	KATEGORIA	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtessa për kushte pune
Nr.			1	2	3	4	5
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%		97713	13000
2	Zv/Drejtor i përgjithshëm	II-b	1	2%		80342	13000
3	Drejtor Drejtorie	III-a	1	2%		59714	14000
4	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		43428	14000
	Përgjegjës zyre	III-b	1	2%		43428	12000
5	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		32571	14000
6	Inspektor i II-të	IV-b	1	2%		21714	13000
7	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		32571	15000
8	Nënoficer		2	2%		15750	9000
9	Llogaritar/Arkëtar		2	2%		17850	11000
10	Operatore		2	2%		15750	9000
11	Arshivist/Protokollist		2	2%		17850	10000
12	Magazinier		2	2%		15750	9000
13	Sekretare	IV-b	1	2%		21714	9000
14	Shofer		2	2%		15750	9000
15	Punonjës pastrimi		3	2%		12600	3000

Lidhja nr.2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DEGËVE TË TATIMEVE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)				Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	POZICIONI	Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
Nr.			1	2	3	4	5
Dega e tatimpaguesve të mëdhenj dhe dega e tatimeve Tiranë							
1	Kryetar dege	III-a	1	2%		59714	16500
	Nënkryetar dege	III-a/1	1	2%		49942	14000
2	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		43428	14000
	Përgjegjës zyre	III-b	1	2%		43428	12000
3	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		32571	14000
4	Inspektor i II-të	IV-b	2	2%		21714	13000
	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		32571	15000
5	Operator		2	2%		15750	9000
8	Llogaritar/Arkëtar		2	2%		21714	11000
11	Shofer		2	2%		15750	9000
14	Arshivist/Protokollist		2	2%		17850	10000
15	Magazinier		2	2%		15750	9000
16	Punonjës pastrimi			2%		12600	3000

Degët e tatimeve në rrethet e tjera

1	Kryetar dege	III-a/1	1	2%		49942	15000
2	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		43428	12000
3	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		32571	12000
4	Inspektor i II-të	IV-b	2	2%		21714	11000
	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		32571	14000
5	Operator		2	2%		15750	9000
	Llogaritar/Arkëtar		2	2%		15750	9000
	Shofer		2	2%		15750	9000
	Arshivist/Protokollist		2	2%		15750	9000
	Magazinier		2	2%		14700	9000
	Punonjës pastrimi			2%		12600	3000

Lidhja nr.3

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	10050
2	Diplomë mbi shkollën e mesme	8950
3	Diplomë e shkollës së mesme	7000
4	Dëftesë lirimi (arsimi tetëvjeçar)	4500

Diploma mbi shkollën e mesme konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program arsimor të

miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen gjithashtu, të gjithë ata që kanë mbaruar dy vite akademike të shkollës së lartë.